



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 259, datë 28.12.2018**

**PËR**  
**NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN NR. 21, DATË 06.02.2018 “PËR**  
**ADMINISTRIMIN E LIKUIDITETIT PËR FONDIN E INVESTIMEVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren nr. 21, datë 06.02.2018 “Për administrimin e likuiditetit për fondin e investimeve”, si më poshtë vijon:

Në nenin 7, pika 3 ndryshon si vijon:

“3. Modeli i provës së rezistencës të përdorur nga shoqëria administruese raportohet në Autoritet brenda muajit janar të çdo viti. Nëse shoqëria administruese vendos të ndryshojë modelin e provës së rezistencës, raporton në Autoritet brenda 10 ditëve nga miratimi i ndryshimeve.”

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 01.01.2019.

**ANËTAR**

**Klodion SHEHU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Ervin KOÇI**